

Njoftim

Në bazë të Nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015 “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni*” i ndryshuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë njofton si më poshtë:

Shoqëria “**FIER THERMOELECTRIC**” Sh.a. ka shprehur interesin dhe ka paraqitur pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, aplikimin për ndërtimin e një termocentrali për prodhimin e energjisë, me kapacitet 170 MW, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën e Roskovecit, Qarku Fier.

Aplikimi i detajuar për publikun e interesuar, të Shoqërisë “**FIER THERMOELECTRIC**” Sh.a., mund të gjendet pranë ambienteve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Adresa: Rruga “Abdi Toptani”, Nr. 1 Tiranë, Faqja web: www.infrastruktura.gov.al

Afatin për dërgimin e objeksioneve ose komenteve në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë është 15 ditë, duke nisur nga data e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare: www.infrastruktura.gov.al